


Bibël për fëmijët

paraqet

Perëndia
Nderon
Jozefin,
Skllavin



Shkruar nga: Edward Hughes
Ilustruar nga: M. Maillot; Lazarus
Adaptuar nga: M. Maillot; Sarah S; Alastair P.
Përkthyer nga: Arianit Iljazi
Prodhuar nga: Bible for Children
www.M1914.org

BFC
PO Box 3
Winnipeg, MB R3C 2G1
Canada

©2020 Bible for Children, Inc.


E drejta e kopjimit: Mund të bëni kopje ose ta shtypni këtë histori,
nëse nuk do ta shitni.




Jozefi u fut padrejtësisht në burg nga ish zotëria i tij, Potifari. Në burg, Jozefi ishte i bindur dhe shumë ndihmës. Kryeroja e burgut i besoi Jozefit të organizonte jetën e të burgosurve.



Që të dy, bukëpjekësi dhe
kupëmbajtësi i mbretit ishin
në burg. "Përse jeni kaq të
trishtuar?" i pyeti Jozefi ata
një ditë.



"Askush nuk na tregon se
çfarë do të thonë ënd'rrat
tona", u përgjigjën burrat të
turbulluar. "Perëndia mundet"
tha Jozefi. "Më tregoni ënd'rrat".



“Ënd’rra jote do të thotë që
në tre ditë ti do të bëhesh
përsëri i preferuari i Mbretit
Faraon”, i tha Jozefi
kupëmbajtësit.




"Kujtohu për mua dhe
kërkoji Faraonit të më
nxjerrë nga burgu". Ëndrra
e bukëpjekesit mbante lajm

të keq. "Ti,
do të
vdesësh në
tre ditë",
tha Jozefi.
Të dyja
ënd'rrat u
vërtetuan.



Por kupëmbajtësi e harroi Jozefin
fare, gjersa Faraoni u ngrit i
turbulluar nga gjumi një ditë. "Kam
parë një ëndërr", bërtiti ai.



Asnjë nga njerëzit e tij
të ditur, nuk ia tregonte
dot kuptimin. Atëherë
kupëmbajtësit iu kujtua
Jozefi në burg. Ai i
tregoi Faraonit rreth tij.




Faraoni dërgoi ta marrin Jozefin menjëherë. "Ënd'rra jote është një mesazh nga Perëndia", i tha Jozefi mbretit. "Egjipti do të ketë shtatë vite begatie, dhe pastaj shtatë vite të tmerrshme zi buke".



"Bëni një plan tani për të grumbulluar ushqim gjatë shtatë viteve të begata", e këshilloi Jozefi Faraonin, "ose njerëzit e tu do të vdesin nga uria prej zisë". "Perëndia është me ty", deklaroi Faraoni. "Ti do të jesh i dyti pas meje në ngarkim të Egjiptit".





Shtatë vitet e begatisë erdhën. Pastaj shtatë vitet e zisë së bukës. Ushqimi ishte i pakët kudo gjetkë me përjashtim të Egjiptit, ku me urtësi kishin grumbulluar sasi shumë të mëdha. Në shtëpinë e Jozefit, në atdheun e tij të largët, familja e Jakobit për pak sa s'po vdiste nga uria.



Njerëz nga të gjitha vendet shkolin në Egjipt, për të blerë grurë. "Edhe ju, duhet të shkoni", urdhëroi Jakobi bijtë e tij "ose përndryshe do vdesim urie". Duke mbërritur në Egjipt, të bijtë u përgatitën të blejnë ushqim.



Bijtë e Jakobit ranë përmbys përpara personit që ishte në ngarkim të Egjiptit. Ata nuk e njohën Jozefin, vëllanë e tyre. Por Jozefi i njohu ata. Jozefit iu kujtuan ëndërrat e tij të djalërisë. Perëndia e kishte ngritur atë mbi vëllezërit e tij.



Jozefi ishte shumë i urtë.
Ai u foli ashpër dhe e
mbajti peng vëllanë
e tij Simeonin.




"Merrni ushqim, shkoni në shtëpi dhe
kthehuni me vëllain tuaj më të ri",
urdhëroi ai. "Kështu unë do
ta di që nuk jeni spiunë".



Vëllezërit menduan që Perëndia po i ndëshkonte ata, pse e kishin shitur Jozefin si skllav shumë vite më parë.



Jakobi dhe bijtë e tij ishin të hutuar. "Paratë tona na janë kthyer brenda grurit. Dhe ai sundusi tha që duhet të sjellim Beniaminin".




Jakobi nuk donte ta linte
Beniaminin të shkonte. Por
shpejt ushqimi mbaroi. Vëllezërit
duhet të shkonin sërish në
Egjipt. Beniamini shkoi me ta.



Kur Jozefi pa Beniaminin, ai urdhëroi shërbëtorët e tij të përgatisnin nje festë të madhe. Vëllezërit u ftuan. "A është ati juaj ende gjallë; a është ai mirë me shëndet?" pyeti Jozefi. Mbase ai po mendonte si ta mblidhte të gjithë familjen së bashku.




Jozefi donte të dinte
edhe nëse vëllezërve
të tij u vinte me të
vërtetë keq, për
mëkatin e shumë
viteve përpara. Pas
banketit, ai i akuzoi
ata për vjedhje.



"Për t'ju dënuar, do të mbaj Benjaminin si skllavin tim", tha Jozefi. "Zoti im, më mirë merr jetën time", u lut Juda. Jozefi e dinte se Juda që kishte propozuar ta

shisnin Jozefin, kishte ndryshuar me të vërtetë.



Duke mos qenë më i aftë ta fshihte dashurinë për familjen e tij, Jozefi i nxorri të gjithë Egjiptasit jashtë.

Pastaj ai filloi të qajë. "Unë jam Jozefi vëllai juaj, të cilin ju e shitët në Egjipt". Të mrekulluar dhe të frikësuar, vëllezërit mbetën pa fjalë.



Jozefi i nxiti vëllezerit e tij. "Perëndia më bëri zot në Egjipt, që të mund të

shpëtoj jetët tuaja nga kjo zi buke. Shkoni sillni babanë tim këtu. Unë do kujdesem për ju".



Jakobi dhe
Jozefi u ribashkuan
në Egjipt, dhe e gjithë
familja jetoi atje në
paqe dhe begati.



Perëndia Nderon Jozefin, Skllavin

Një tregim nga Fjala e Perëndisë, Bibla


e marrë nga

Zanafilla 39 - 45


"Zbulimi i fjalëve të tua ndriçon dhe u
jep mendje njerëzve të thjeshtë."

Psalmet 119:130





8



60



Ky tregim nga Bibla na tregon për Perëndinë tonë të
mrekullueshëm i cili na krijoi dhe dëshiron që
ne ta njohim Atë.

Perëndia e di që ne kemi bërë gjëra të këqija, të cilat Ai i quan
mëkate. Dënimi për mëkatin është vdekja, por Perëndia ju do juve
aq shumë sa që dërgoi Birin e Tij të vetëm, Jezusin, që të vdesë në
Kryq dhe të dënohet për mëkatet tuaja. Pastaj Jezusi u ringjall
dhe u ngrit lart në Qiell! Nëse beson në Jezusin dhe i kërkon Atij
të t'i falë mëkatet e tua, Ai do ta bëjë atë! Ai do të vijë dhe do të
jetojë në ty, dhe ti do të jetosh me Të përgjithmonë.

Nëse ti beson se kjo është e vërteta, drejtoju Perëndisë kështu:
Jezus i dashur, unë besoj se Ti je Perëndia i bërë njeri për të
vdekur për mëkatet e mia, dhe që Ti u ngjalle sërish. Të lutem,
eja në jetën time dhe fali mëkatet e mia, në mënyrë që unë të kem
jetë të re dhe një ditë të jem me Ty, përgjithmonë. Më ndihmo,
të të bindem dhe jetoj për Ty, si fëmija Yt. Amen.

Lexo Biblën dhe bisedo me Perëndinë çdo ditë! Gjoni 3:16

